



Periodiku AMF

I. 1 vjetori I AMF “Zhvillimi dhe sfidat e tregjeve financiare jo – bankare”

Me rastin e 1 vjetorit të krijimit , më 10 Dhjetor 2007 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi në Hotel Sheraton dhe Kullat takimin “Zhvillimi dhe sfidat e tregjeve financiare jo – bankare”, për të paraqitur punën e kryer nga ky institucion në vitin e parë të aktivitetit të tij dhe më tej objektivat e projektet për përballimin me sukses të sfidave të zhvillimit të tregjeve financiare jo – bankare.

Vijon në faqen 2

Fjala e Kryetares Zj. Elisabeta Gjoni në 1 vjetorin e AMF

Të nderuar pjesëmarrës,
Së pari, do të dëshiroja t’ju shprehja falënderimet e sinqerta që na nderuat me pjesëmarrjen tuaj, duke gjetur hapësirë në skedulin aq të ngjeshur të fundvitit.

Vijon në faqen 3

II. Vështrim mbi tregun e sigurimeve gjatë vitit 2007

Gjatë vitit 2007, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 5,935,377 mijë lekë, perkundrejt 4,543,217 mijë lekë të realizuara gjatë vitit 2006.

Tregu i sigurimeve ka një rritje në masën 30.64 % nga viti i kaluar, ku 92.67 % e kësaj rritje i takon tregut të sigurimeve të Jo Jetës, ndërsa 7.33 % tregut të sigurimeve të Jetës. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, kemi një rritje në masën 33.17 % të sigurimeve të Jetës dhe 30.46 % të sigurimeve të Jo – Jetës.

Vijon në faqen 8

III. Mbikëqyrja me Bazë Riskun

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvillon funksionet e veta të mbikëqyrjes së tregjeve financiare jo-bankare përmes monitorimit të tregjeve në tërësi dhe të performancës së aktorëve të tregut në veçanti. Gjithnjë e më tepër mbikëqyrja është duke u fokusuar në identifikimin, matjen, parandalimin dhe eliminimin e shkallës së rreziqeve që kërcënojnë performancën e tregut dhe si rrjedhim interesat e konsumatorëve.

Vijon në faqen 9

IV. Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Konferenca e IOSCO-së
Autoriteti i Shërbimeve Financiare të Dubait (DUBAI Financial Services Authority) dhe Organizata e IOSCO-së zhvilluan në Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe më 3-6 Dhjetor 2007 konferencën e IOSCO-së e vendeve në zhvillim (IOSCO EMC-Emerging Markets Committee conference).

Vijon në faqen 11

V. Parimet e IAIS

Regjimi i mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe aftësisë paguese duhet të jenë të ndjeshëm ndaj riskut

Vijon në faqen 12

Në këtë numër:

1 vjetori I AMF “Zhvillimi dhe sfidat e tregjeve financiare jo – bankare” 2

Vështrim mbi tregun e sigurimeve gjatë vitit 2007 8

Mbikëqyrja me Bazë Riskun 9

Ngjarje dhe zhvillime të tjera 11

Parimet e IAIS 12

1 Vjetori i AMF “Zhvillimi dhe sfidat e tregjeve financiare jo – bankare”

Me rastin e 1 vjetorit të krijimit, më 10 Dhjetor 2007 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi në Hotel Sheraton dhe Kullat takimin “Zhvillimi dhe sfidat e tregjeve financiare jo – bankare”, për të paraqitur punën e kryer nga ky institucion në vitin e parë të aktivitetit të tij dhe më tej objektivat e projektet për përballimin me sukses të sfidave të zhvillimit të tregjeve financiare jo - bankare. AMF filloi aktivitetin e saj rreth një vit më parë, duke integruar funksionet e kryera nga rregullatorët e mëparshëm në fushat e sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private suplementare.

Në takimin e ndjekur nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme, mori pjesë Kryeministri i vendit, Prof. Sali Berisha, Ministri i Financave Z. Ridvan Bode, Ministri i Ekonomisë Z. Genc Ruli, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë Z. Adrian Fullani, Z. Hashim Rexhepi Zv / Drejtori i Autoritetit Bankar Qendror të Kosovës dhe personalitete të tjera në vend.

Në fjalën e saj, Zj. Elisabeta Gjoni – Kryetare e AMF-së evidentoi fushat e prioriteteve të institucionit në vitin e parë të punës. Këto prioritete lidhen me diagnostikimin e tregut, me fokus atë të sigurimeve; hartimin e një plani të plotë të zhvillimit të mbikëqyrjes; rishikimin e kuadrit ligjor ekzistues për tregjet financiare jo-bankare dhe përshtatjen e tij me direktivat Europiane e standardet ndërkombëtare dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të teknologjisë së informacionit me baza të dhënash të shumëfishta. Në harkun e një viti, AMF ka ndjekur me vëmendje dhe ka trajtuar problemet që lidhen me zhvillimin e tregjeve të sigurimeve, letrave me vlerë dhe sigurimeve në Shqipëri. Në diagnostikimin e tregut të sigurimeve janë përfshirë elementë të metodologjisë bashkëkohore të mbikëqyrjes me bazë riskun. Rezultatet e analizave janë reflektuar në adoptimin e rregulloreve dhe dhe nxjerjen e



konkluzioneve përkatëse e rekomandimeve për shoqëritë.

Ndër arritjet e punës 1 vjeçare të AMF-së u përmendën: Krijimi i qendrës kombëtare të të dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik në funksion të zgjidhjes së problemeve dhe modernizimit të infrastrukturës së sigurimeve të detyrueshme, hartimi dhe nxjerrja e një sërë aktesh nënligjore që pasqyrojnë direktivat europiane për të tre sektorët, amendime në ligjet ekzistuese për çështje të rëndësishme si niveli i fondit të garancisë, krijimi i sistemit GSRM për fushën e letrave me vlerë, zhvillimi i trainimeve të ndryshme, forcimi i rolit të profesionalistëve në sistemin financiar, etj. Në drejtim të rritjes së komunikimit dhe transparencës me publikut AMF ka vënë në dispozicion të publikut informacione të ndryshme të përditësuara në faqen e internetit.

Në fjalën e tij, Kryeministri i Shqipërisë, Z. Sali Berisha ndër të tjera tha se krijimi i këtij institucioni erdhi si rezultat i kërkesave në rritje për rregullimin e tregut financiar jo – bankar. Tre autoritete u shkri në një : i sigurimeve, i pensioneve dhe letrave me vlerë dhe në standardin më të mirë ekzistues u krijua AMF. Në 1 vit është dëshmuar qartë që AMF po përmbush misionin e saj shumë të rëndësishëm për zhvillimin e tregjeve bankare financiare dhe para së gjithash mbrojtjen e konsumatorit. Në bashkëpunim me qeverinë janë marrë dhe po merren masa të pandërprera për rritjen dhe zhvillimin e tregjeve financiare jo – bankare. Shqipëria ka një ekonomi të re, dinamike dhe entuziaste, por kjo ekonomi duhet të shohë rregullat dhe të garantojë qëndrueshërinë. Shqipëria është

absolutisht para asaj që ne e mendojmë dhe nuk është ajo që tërheqim ne, por është ajo që na tërheq ne. Reforma e pensioneve është nga reformat më të mëdha kudo sot, jo vetëm për Shqipërinë. Ne do të hapim një debat konstruktiv me opozitën, për të gjetur një ujdi, pasi është reformë që instalohet për afate shumë të gjata.

Ministri i Financave theksoi rëndësinë e krijimit të AMF-së si institucion rregullator i integruar, duke u ndalur në zhvillimet e vrullshme në tregjet e sigurimeve, pensioneve dhe letrave me vlerë dhe rolin që ata kanë në zhvillimin makroekonomik të vendit.

Rëndësia e bashkëpunimit midis tregjeve dhe rregullatorëve në rajon dhe kontributi i shoqërive shqiptare në zhvillimin e tregjeve financiare jo – bankare të Kosovës, zunë një vend të vecantë në fjalën e Z. Hashim Rexhepi, nënkryetar i Autoritetit Bankar Qendror të Kosovës. Ai u ndal në problemet e sigurimeve të detyrueshme në Kosovë dhe në gjetjen e rrugëve për liberalizimin e këtij tregu.

Bashkëpunimi midis institucioneve rregullatore në vend në drejtim të mirëfunksionimit dhe zhvillimit të tregjeve financiare zuri një vend të rëndësishëm në fjalën e Guvernatorit Fullani, ndërsa interes të vecantë paraqitën prezantimet mbi klimën për investimet e huaja në sektorin financiar nga përfaqësuesi i shoqërisë TBIH, Christian Wolfs dhe rëndësia e zhvillimit të tregut të letrave me vlerë nga përfaqësuesi i BKT-së, Z. Seyhan Pencapligil.

Fjala e kryetares në 1 vjetorin e AMF Zj. Elisabeta Gjoni

Të nderuar pjesëmarrës,

Së pari, do të dëshiroja t'ju shprehja falënderimet e sinqerta që na nderuat me pjesëmarrjen tuaj, duke gjetur hapësirë në skedulën aq të ngjeshur të fundvitit.

Duke ju uruar mirëseardhjen në aktivitet, kam kënaqësinë të paraqes sot përpara jush një ekspozitë të punës dhe arritjeve të AMF-së në vitin e parë të

veprimtarisë së saj. Gjithashtu, do të përmend edhe objektivat e projektet për përballimin me sukses të sfidave të zhvillimit të tregjeve financiare jo – bankare.

AMF filloi aktivitetin e saj rreth një vit më parë, duke integruar funksionet e kryera nga rregullatorët e mëparshëm në fushat e sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private suplementare.

Më lejoni të bëj një vështrim të shkurtër historik: Qeveria, në ndjekje të tendencave të zhvillimit në vend dhe ato ndërkombëtare në këtë fushë, si edhe në përgjigje të rekomandimeve të Bankës Botërore e FMN-së në Raportin e Vlerësimit Financiar 2004-2005, ndër morri reformën institucionale të integrimin të rregullatorëve financiarë jo – bankarë.

Unifikimi i tre rregullatorëve u konsiderua nga Qeveria si një proces dhe jo si një vendim i vetëm, apo miratim i një ligji.

Hapat e procesit:

- o Diskutimet paraprake deri në Janar 2006;
- o Marrja e vendimit politik;
- o Ngritja e grupit të punës;
- o Hartimi i strategjisë dhe i ligjit;
- o Diskutimet përfundimtare;
- o Miratimi i ligjit;
- o Miratimi i Bordit në Tetor 2006.

Me mbështetjen e pandërprerë të BB brenda vitit 2006 u realizuan të gjithë hapat e nevojshëm ligjorë, teknikë dhe administrativë që mundësuan në Tetor 2006 fillimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

AMF-ja në gjithë veprimtarinë e saj drejtohet nga një mision qartësisht i përcaktuar: garantimi dhe mbrojtja e interesave të investitorëve, të siguruarve dhe publikut në tërësi. Në këtë këndvështrim, mbetet domosdoshmëri që në çdo kohë të ruhet qëndrueshmëria financiare e lojtarëve të tregut dhe aftësia e tyre për të përmbushur në kohë detyrimet.

Që me krijimin e saj, AMF me asistencën e BB krahas përpjekjeve të vazhdueshme për ngritjen e kapaciteteve institucionale, identifikoi fushat e prioriteteve:



- o Diagnostikimi i tregut, me fokus atë të sigurimeve;
- o Hartimi i një plani të plotë të zhvillimit të mbikëqyrjes;
- o Rishikimi i të gjithë kuadrit ligjor ekzistues për tregjet financiare jo-bankare dhe përshtatja e tij me direktivat Europiane e standardet ndërkombëtare;
- o Zhvillimi i një sistemi të përshtatshëm të teknologjisë së informacionit me baza të dhënash të shumëfishta.

Vlerësimi intensiv i situatës së tregut (Nëntor – Dhjetor 2006) u shoqërua me futjen e metodave profesionale analizuuese, siç ishte zbatimi i sistemit IRIS (Sistemi Informativ Rregullativ të Sigurimeve). Për këtë qëllim, me mbështetjen e Bankës Botërore, AMF zhvilloi në dhjetor 2006 një trainim të stafeve të saj dhe të shoqërive të sigurimeve mbi metodat bashkëkohore të analizës financiare në sigurime dhe përdorimin e normave dhe testeve të përshtatura për Shqipërinë.

Dua të theksoj se kjo metodologji është aplikuar gjatë gjithë analizave deri më sot dhe raportet periodike mbi gjëndjen financiare kanë përcjellë mesazhet përkatëse tek shoqëritë.

Diagnostikimi i menjëhershëm u përqëndrua në vlerësimin e administrimit të dëmeve, të praktikave të mbajtjes e administrimit të rreziqeve, të risigurimeve dhe të aftësisë paguese të çdo shoqërie të sigurimit.

Problemet kryesore që rezultuan nga diagnostikimi si:

- o raporti i ulët i humbjeve (dëme / prime);
- o shpenzimet e larta administrative;
- o efektiviteti i ulët i kapitalit;

u pasqyruan më tej në objektiva specifike të veprimtarisë së AMF.

Brenda këtij viti objektivat u konkretizuan me: adoptimin dhe miratimin nga AMF të dokumentit të OECD-së mbi Praktikën e Mira të Trajtimit të Dëmeve

në Sigurime, në bashkëpunimin me Ministrinë e Financave për nxjerrjen e Udhëzimit mbi Vlerësimin e Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorrike, si dhe të rregullores mbi kriteret e risigurimeve.

Në drejtim të risigurimeve, po punohet për gjetjen skemave më të përshtatshme si: krijimi i një njësie kombëtare të risigurimit, grumbullimi i biznesit nga sigurues të ndryshëm para kalimit të rreziqeve në tregjet ndërkombëtare. Ndërmarje të tilla i shërbejnë rritjes së efektivitetit të biznesit dhe mbështesin programe kombëtare të mbrojtjes nga katastrofat natyrore.

Një ndër ndërhyrjet më të ndjeshme ligjore mbi tregun e sigurimeve ishte rritja e nivelit minimal të fondit të garancisë në nivelet e përcaktuara në direktivat europiane. Me kënaqësi informoj përmbushjen nga siguruesit Shqiptarë të dy niveleve të para të rritjes së fondit të garancisë të parashikuara brenda vitit 2007. Të shpresojmë kështu edhe për nivelin e fundit në mars të 2008.

Zhvillimi i funksioneve të AMF-së u pa i lidhur ngushtë me hartimin e një strategjie të plotë të mbikëqyrjes dhe vënia në jetë e saj nëpërmjet një plani të qartë veprimi.

Po përmend shkurt disa momente kyçe, pasi nënkryetarët me prezantimet e tyre do të japin një pamje më të plotë.

- o Hartimi e përdorimi i një sistemi të analizës të strukturuar qartë dhe të orientuar tek çështjet thelbësore
- o Përfshirja e elementëve të mbikëqyrjes me bazë risku në sistemin e analizës
- o Aktet nënligjore mbi mbulimin e provigjoneve, vlerësimin e dëmeve, veprimtarinë e risigurimeve, nën dritën e direktivave Europiane dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

AMF po bashkëpunon ngushtë me Bankën Botërore për realizimin e projektit të hartimit të metodologjisë së plotë të mbikëqyrjes efektive me bazë riskun, që do t'i ketë rezultatet e saj në vitin e ardhshëm.

Kjo përjasje e re kërkon të mbështetet nga një sistem elektronik bashkëkohor i raportimit dhe analizës. Kam kënaqësinë t'ju informoj se Bordi i Drejtorëve të BERZH-it miratoi projektin e zhvillimit të sistemit informatik të raportimit të AMF-së për sigurimet e pensionet dhe se në 7 dhjetor u mbështet unanimisht edhe nga donatorët e Fondit të Ballkanit Perëndimor. Ngritja e një platforme të tillë informatike do të garantojë: një komunikim të shpejtë e të besueshëm, kapacitete shumë të larta të analizës, si edhe paralajmërime të hershme, si element shumë i rëndësishëm i mbikëqyrjes. Platforma të tilla përdoren sot në vende të zhvilluara si Britania e Madhe, Irlanda, Sllovenia, etj.

AMF ka ndjekur dhe trajtuar me vëmendje të veçantë zhvillimet në sigurimet e detyrueshme motorike, që zënë mbi 65% në strukturën e tregut të sigurimeve. Është për t'u theksuar që këtë vit ky treg ka një rritje të ndjeshme me rreth 52% (10 mujori) në krahasim me vitin e kaluar, që vjen jo vetëm nga ndryshimi i tarifave për një periudhë 4 mujore, por edhe nga rritja e numrit të kontratave të sigurimit.

Megjithatë, fenomeni i shitjes nën primet e miratuara me impakt në përkeqësimin e fitimeve, vazhdon të përbëjë një plagë të tregut të sigurimeve. Kompleksi i masave të përbashkëta, deri në politika të liberalizimit, duhet të shoqërohet me një sjellje të re të konkurrencës nga shoqëritë e sigurimit.

Nuk do të lija pa përmendur projektin ambicioz të ngritjes së Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik. Ngritja e Qendres buron si një kërkesë e tregut, e direktivave të Europës dhe e mbikëqyrjes dhe është dhe në funksion të politikave të liberalizimit gradual të çmimeve të sigurimeve të detyrueshme dhe mirëadministrimit të dëmeve.

Në bashkëpunim me shoqëritë e sigurimit, AMF mundësoi përmbylljen me sukses të fazës së parë, që do të thotë se çdo policë motorrike sot shitet në mënyrë elektronike dhe raportohet në kohe reale në këtë Qendër të administruar nga AMF. Dua të përshëndes bashkëpunimin për këtë projekt me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit dhe Transportit Rrugor dhe Qendrën analoge Tramer në Turqi.

Të gjitha këto reforma, si edhe ristrukturimi i arkitekturës institucionale të sigurimeve motorrike, po gjejnë shprehje në projektin e një ligji të ri të sigurimeve të detyrueshme, për të cilin AMF është duke punuar.

Ne kemi vendosur një dialog sistematik me tregun dhe shoqatat përkatëse për konsultime paraprake, trainime apo drejtime të tjera të bashkëpunimit. Së fundmi, edhe në faqen e internetit të AMF-së shoqëritë mund të gjejnë informacione konfidenciale të aksesueshme vetëm prej tyre.

Në fund të vitit 2008, shoqërive të shërbimeve financiare do t'u duhet të raportojnë pasqyrat e tyre financiare sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar. Duke e parë këtë si një sfidë të madhe për sektorin, AMF ka ndërmarrë nisma të trainimit me pjesëmarrjen e lektorëve ndërkombëtarë me përvojë.

AMF po bashkëpunon me institucione të tjera për një shtrirje më të gjerë të veprimtarisë siguroese, në mbështetje të iniciativës së Qeverisë e të Kryeministrit për mbrojtjen e publikut, apo punonjësve nga rreziqe potenciale që mbart ushtrimi i disa aktiviteteve si: karburantet, ndërtimi, minierat, hoteleria, etj. Promovimi i një sërë produktesh të domosdoshme të sigurimeve do të ketë si rrjedhim edhe përmirësimin e strukturës së këtij tregu.

Shqipëria është një vend shumë i ekspozuar ndaj rreziqeve dhe katastrofave natyrore. Për këtë arsye, mbetet domosdoshmëri zhvillimi i skemave kombëtare të mbrojtjes ndaj tyre dhe reduktimit të pasojave që ato mund t'u sjellin familjeve, bizneseve dhe ekonomisë së vendit në tërësi. Hartimi i programeve të mbrojtjes nga katastrofat mbetet një sfidë madhore për tregjet financiare në Shqipëri. AMF ka paraqitur vlerësimet e saj për të gjetur konsensusin e nevojshëm në ndërmarrjen e një projekti të tillë kombëtar.

Megjithëse së bashku i kemi celebruar, nuk mund të lë pa përmendur se zhvillimet e këtij viti në tregun e sigurimeve do të mbeten të shënuara. Për herë të parë investitorë të huaj me reputacion në Europë janë të pranishëm në Shqipëri, në partneship të suksesshëm me shoqëritë Shqiptare. (Në Prill – Aspis, në Korrik – Uniqa, e në Gusht – TBIH).



Këto zhvillime nuk janë të rastësishme: qëndrueshmëria makroekonomike, zhvillimet e fundit të sektorit financiar, progresi në regjimin e rregullimit dhe mbikëqyrjes të gërshetuara me potencialet e mëdha që ofron vendi, janë faktorë që kanë ndikuar në rritjen e interesit të investitorëve. Investitorë prestigjiozë janë në proces negociatash dhe vlerësimi për shoqëri të tjera, ndërkohë që vëmendje e madhe po i kushtohet nga tregjet ndërkombëtare privatizimit të plotë të INSIG-ut.

Në sektorin e pensioneve, AMF po punon për hartimin e një projekt-ligji të ri të pensioneve private vullnetare, që do të nxisë më tej zhvillimin e këtij sektori mbi baza të forta të garantimit dhe mbrojtjes së interesave të kontribuesve vullnetarë. Ndërkohë, për mbikëqyrjen e tri fondeve ekzistuese, AMF ka hartuar dhe miratuar rregulla të raportimit e monitorimit.

Është për t'u theksuar se AMF mbetet pjesë aktive e studimeve dhe vlerësimeve të iniciuara nga Qeveria me qëllim reformimin e sigurimeve shoqërore dhe pensioneve.

Tregu i letrave me vlerë sot kufizohet vetëm në letrat me vlerë të qeverisë. AMF ka mundësuar zgjerimin e tregut dytësor dhe funksionimin e rregjistrave përkatës, nëpërmjet liçencimit amendimeve rregullatore dhe me një bashkëpunim të ngushtë me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave. Dëshiroj të prek këtu realizimin me sukses të sistemit GSRM. AMF në perpjekje për të rritur transparencën dhe tregtueshmërinë ka instaluar në faqen e internetit një sistem rating (krahasimi) GSRM, ku çdo bankë përditëson në kohë reale transaksionet dhe kuotimet për bonot e thesarit dhe obligacionet. Mendojmë se emetimet afatgjata ngrenë nevojën për një strukturë qendrore të regjistrimit.

Interesi që është shfaqur për tregun e kapitaleve, si dhe kushtet e sotme të zhvillimit të biznesit dhe të infrastruktures institucionale favorizojnë aktivizimin e tij. E them me siguri se sot në vendin tone ka shoqëri që janë plotësisht të përshtatshme për t'u listuar në Bursë. Në këtë terren, një perpjekje e përbashket e institucioneve financiare e promovon ndjeshëm procesin.

Po vijon puna për përmirësimin e kuadrit ligjor në

fushën e letrave me vlerë, ku dëshëroj të përmend projektin e ri të ligjit të letrave me vlerë të hartuar nga Ministria e Financave, projektin në proces mbi Obligacionet e Korporatave dhe Bashkive të mbështetur nga BERZH-i dhe hartimin e projekt-ligjit të ri mbi investimet kolektive. Këto projekte synojnë përafrimin me direktivat Europiane dhe nxitjen e aktivizimit të tregut.

Në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar, AMF mban një bashkëpunim të ngushtë dhe sistematik me Bankën e Shqipërisë.

Bashkëpunimi ndihmon në parandalimin e transferimit të rreziqeve, të rritjes së transparencës, si edhe të unifikimit të standardeve për sektorin financiar. Konkretisht, mjaft të efektshme kanë qënë në këtë drejtim inspektimet e përbashkëta. Aplikimet e platformave teknologjike do të mundësojnë një shkëmbim informacioni e komunikim akoma më të plotë e sistematik.

AMF është anëtare e 3 shoqatave ndërkombëtare të rregullatorëve të sigurimeve (IAIS), letrave me vlerë (IOSCO) dhe pensioneve (IOPS) dhe ka marrëdhënie e bashkëpunim të ngushtë me një numër të madh rregullatorësh në botë. Vlen këtu të përmendet forcimi i bashkëpunimit me Autoritetin Austriak të Tregjeve Financiare menjëherë pas investimeve Austriake në tregun Shqipëtar të sigurimeve dhe pensioneve.

AMF ka një bashkëpunim të vazhdueshëm me Autoritetin Bankar Qendror të Kosovës, me fryte reciproke si në shkëmbimin e eksperiencës, në vendosjen e standardeve, në zhvillimin e trainimeve dypalëshe, ashtu edhe në shkëmbimin e informacioneve konfidenciale në kryerjen e inspektimeve të përbashkëta në shoqëritë shqipëtare në Kosovë. Këto ura komunikimi do të forcohen më tej në funksion të zhvillimit të sektorëve financiarë të të dy vendeve.

Një ndër synimet e tona mbetet përgatitja e profesionistëve të tregjeve financiare ku mund të përmend: vlerësuesit, aktuarët, ndërmjetësit, analistët, etj. Me kënaqësi mund të them sot, se vetëm dy ditë më parë, AMF së bashku me USAID-in çertifikuan klasën e parë të aktuarëve profesionistë në Shqipëri. AMF përgëzon këtë grup profesionistësh

dhe premtori që do të garantojë rritjen dhe zhvillimin e këtij profesioni, si nëpërmjet rregullimeve ligjore, ashtu edhe me mbështetjen për krijimin e shoqatës profesionale dhe vlerësimin të rekomandimeve të specializuara të tyre. Gjithashtu, AMF ka miratuar dhe besoj se brenda këtij viti do të miratohen dy VKM për vlerësuesit e dëmeve dhe ndërmjetësit (agjentë / broker).

Vendosja e një komunikimi të hapur me publikun mbetet një nga përparësitë e punës të AMF-së në funksion të përmbushjes së misionit të saj themelor. Transparenca jonë ka synim informimin mbi të gjitha zhvillimet e tregjeve financiare jo – bankare në Shqipëri e më gjerë, duke shërbyer në të njëjtën kohë për edukimin dhe rritjen e interesit dhe besimit të konsumatorit për produktet financiare. AMF ka vënë në dispozicion të publikut faqen e plotë interaktive të internetit, publikime mujore të raporteve statistikore e periodikut dhe botime të tjera informative edukuese.

Në vijim të prezantimit të aktivitetit një vjeçar, do të doja të ndalesha pak dhe në një prioritet me peshë sidomos për vitin e parë, atë të ngritjes dhe konsolidimit të kapaciteteve institucionale.

Modeli i integritetit funksional u reflektua në strukturën organike të institucionit, që megjithëse ishte pjesë e strategjisë së krijimit, u bë e mundur të realizohet vetëm pas disa muajsh. Struktura e re siguron ndarjen e qartë të funksioneve, lehtëson unifikimin e standarteve dhe procedurave për gjithë sektorin financiar, si edhe mundëson sfidat e integritetit.

AMF ka zhvilluar (me mbështetjen e FSVK-së) një strategji të burimeve njerëzore, me politika të fokusuar kryesisht në drejtim të përzgjedhjes së stafi të kualifikuar, të nxitjes dhe motivimit në punë, rritjes së kapaciteteve nëpërmjet mbështetjes për trainime e certifikime profesionale të niveleve ndërkombëtare.

Funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm, si një siguresë e institucionit, ndihmon për të evidentuar risqet dhe për të garantuar përputhshmërinë ligjore. Gjatë këtij viti, bordi i kompozuar nga 7 anëtarë ka zhvilluar mbledhje të shpeshta për të përmbushur një sërë detyrimesh ligjore për ngritjen dhe funksionimin

institucional të AMF-së, për zbatimin e shkrirjes dhe konsolidimit të tre rregullatorëve ekzistues. Njëkohësisht, bazuar në punën e vlefshme të stafit, si edhe këshillimet e Bankës Botërore, Bordi ka ndjekur me kujdes zhvillimet e tregut, duke ushtruar me përgjegjësi kompetencat për mbikëqyrjen e kujdesshme të tregut. Gjatë një viti janë marrë një sërë vendimesh të rëndësishme rregullatore dhe funksionale.

AMF funksionon ende në ambiente zyresh jo të përshtatshme, sidomos në kushtet e aplikimit të projekteve afatgjata të teknologjisë.

Hapat e hedhura në këtë vit për vetë kompleksitetin e fushës, shtrihen në shumë drejtime dhe konturojnë qartë një të ardhme të qëndrueshme.

Sfidat që kemi përpara janë të mëdha, por ju garantoj se akoma më i madh do të jetë përkushtimi ynë për t'i përballuar ato me sukses.

Vështrim mbi tregun e sigurimeve gjatë vitit 2007

Gjatë vitit 2007, primet e shkruara bruto kapën vleren prej 5,935,377 mijë lekë, kundrejt 4,543,217 mijë lekë të realizuara gjatë vitit 2006.

Tregu i sigurimeve ka një rritje në masën 30.64 % nga viti i kaluar, ku 92.67 % e kësaj rritje i takon tregut të sigurimeve të Jo-Jetës, ndërsa 7.33 % tregut të sigurimeve të Jetës. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, kemi një rritje në masën 33.17 % të sigurimeve të Jetës dhe 30.46 % të sigurimeve të Jo-Jetës.

Gjatë vitit 2007, volumi i primeve nga sigurimi i detyrueshëm është rritur në masën 29.84 % (nga të cilat vlen të përmendet pesha që ka portofoli MTPL në këtë rritje: 91.93 %), ndërsa volumi i primeve të sigurimit vullnetar të Jo-Jetës janë rritur në masën 31.92 %.


Në vitin 2007 u lidhën 543,743 kontrata sigurimi përkundrejt 507,382 kontrata të lidhura gjatë vitit 2006. Numri i kontratave të sigurimit të Jo-Jetës kap vlerën 502,810 nga 483,940 që i takojnë të njëjtës periudhë të një viti më parë. Portofoli MTPL ka shënuar rritjen më të madhe të numrit të kontratave me 32,082 kontrata ose në masën 19.40 %.

Vlen të përmendet rritja në masën 74.61 % e numrit të kontratave të sigurimit të Jetës kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Numri i kontratave të sigurimit të Jetës kap vlerën 40,933 nga të cilat sigurimi “Jeta dhe shëndeti në udhëtim” ka një rritje prej 9,753 kontrata, duke shënuar dhe dinamikën më të lartë në rritjen e kontratave të sigurimit të jetës.


Tabelë: Volumi i primit te shkruar bruto gjatë vitit 2007

Viti	Vlera (në mijë Lekë)	
	2006	2007
A) Sigurimi i Jetës	307,517	409,525
B) Sigurim i Jo – Jetës	4,235,700	5,525,852
<i>Nga këto</i>		
a) Sigurimi Detyrueshëm	2,976,912	3,865,250
b) Sigurimi Vullnetar	1,258,788	1,660,602
TOTAL	4,543,217	5,935,377

Grafik: Volumi i primit të shkruar bruto gjatë vitit 2007 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Grafik: Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit gjatë vitit 2007 (Jo-Jeta)



Mbikëqyrja me bazë Risku

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvillon funksionet e veta të mbikëqyrjes së tregjeve financiare jo-bankare përmes monitorimit të tregjeve në tërësi dhe të performancës së aktorëve të tregut në veçanti. Gjithnjë e më tepër mbikëqyrja është duke u fokusuar në identifikimin, matjen, parandalimin dhe eliminimin e shkallës së rreziqeve që kërcënojnë performancën e tregut dhe si rrjedhim interesat e konsumatorëve.

Mbikëqyrja Tradicionale

- o Garantimi i sigurisë së institucioneve financiare nëpërmjet vendosjes së rregullave;
- o Rregullat janë të zbatueshme për të gjitha institucionet financiare dhe përcaktohen me ligj;
- o Vendosja e sanksioneve në funksion të zbatimit të rregullave.

Çfarë bën Mbikëqyrja me bazë riskun?

- o Vlerëson biznesin e një kompanie, profilin e riskut dhe kontekstin makro-ekonomik në dy dimensione:
 1. Profilet individuale të risqeve;
 2. Riskun sistematik;
- o Analizimi i impaktit që një falimentim i mundshëm mund të ketë kundrejt:
 1. Policëmbajtësve;
 2. Sistemit financiar;
- o Dizenjimi i një sistemi efektiv mbikëqyrës;

Avantazhet

- o Menaxhim risku më i mirë;
- o Treg më eficient;
- o Rritje e kapaciteteve mbajtëse të riskut;
- o Efekte pozitive ekonomike edhe në nivel makro;

Sfidat

- o Kërkon më shumë eksperiencë dhe aftësi sesa modeli tradicional i bazuar në rregulla;
- o Hartimi i metodologjive të sofistikuara (manuale të brendëshme, trajnime etj.);
- o Pranimi dhe adoptimi i metodologjive nga stafi mbikëqyrës;
- o Model i bazuar mbi gjykim i cili mund të mos jetë gjithmonë objektiv;
- o Gjykimi mbikëqyrës mund të sfidohet nga institucionet financiare – vështirësi për të provuar saktësinë nga secila palë;
- o Modeli tërësisht i bazuar në gjykim vështirëson fazat e ndërhyrjes nga ana e Mbikëqyrjes;

Implementimi kërkon:

- o Politika institucionale dhe reformë ligjore për mbikëqyrjen e sistemit financiar;
- o Infrastrukturë të tregut financiar;
- o Sistem efikas ligjor dhe gjyqësor, me qëllim zbatimin e vendimeve;
- o Standarte kontabiliteti, aktuariale dhe auditimi;
- o Ekspertë në audit, kontabilitet dhe aktuaristikë;
- o Statistika financiare, sociale dhe ekonomike;
- o Tregje financiare eficiente – mundësi afat-mesme dhe afat-gjata investimi;

A mund të implementohet në Shqipëri?

Në kushtet e Shqipërisë implementimi i një sistemi të tillë është një sfidë më vete dhe duhet parë në një këndvështrim më afat-gjatë. AMF është duke punuar për gjetjen e një zgjidhje alternative e cila do të shërbejë si një urë kalimi nga sistemi aktual drejt praktikave dhe standarteve bashkëkohore, që kanë bazë riskun.

Në periudhën nëntor – dhjetor 2006 AMF, me mbështetjen teknike të Bankës Botërore kreu një diagnostikim të tregut të sigurimeve, duke shqyrtuar eksperiencën dhe gjendjen aktuale të tij. Analiza shërbeu për identifikimin e problemeve, fenomeneve të tregut, tendencave dhe skenarëve të mundshëm në të ardhmen.

Diagnostikimi i gjendjes financiare të sektorit të sigurimeve u përqëndrua në vlerësimin e shoqërive nëpërmjet normave të sistemit IRIS (Sistemi Informativ Rregullativ i Sigurimeve) të përshtatura për shoqëritë e sigurimit të jo-jetës në Shqipëri. Ky diagnostikim përfshiu vlerësimin e administrimit të dëmeve, të praktikave të mbajtjes së rrezikut dhe të aftësisë paguese të shoqërive të sigurimit, si hapi i parë drejt një strategjie të plotë të AMF-së me qëllim hartimin e konkluzioneve fillestare dhe vijimin më tej të veprimtarisë mbikëqyrëse.

Raportet financiare të modelit të mësipërm vlerësohen shumë të rëndësishme në ndërtimin e një sistemi të paralajmërimit të hershëm (early warning), si element themelor i modelit modern të mbikëqyrjes me bazë riskun. Paralajmërimi i hershëm synon evidentimin në kohën e duhur të problemeve që mund të çenojnë interesat e konsumatorëve dhe stabilitetin e tregut, si edhe monitorimin në vazhdimësi dhe ndërhyrjen, apo marrjen e masave përkatëse nga AMF.

Testet IRIS mbi gjendjen financiare të shoqërive të sigurimit në Shqipëri për vitin 2006

Rëndësia e raporteve (indikatorëve financiarë IRIS) – Diapazonet e vlerave të raporteve.

Raporti	Maksimum	Minimum
Norma e Rritjes së Primit	+ 40	- 40
Mbajtja Neto	80	40
Raporti Shpenzimeve	50	25
Raporti Dëme/Prime	80	50
Raporti i Kombinuar	105	85
Të Ardhura nga Investimet	8	4
Të Ardhura të Tjera	1	N/A
Raporti Operativ	101	80
Raporti i Fitimit	20	- 1
Kapitali ndaj të Primeve Bruto	50	20
Kapitali ndaj Provigj. Teknike	30	10
Raporti i Aftësisë Paguese	300	150

Në proçes

AMF synon rritjen e efektivitetit të proçeseve të mbikëqyrjes së tregjeve financiare jo – bankare nëpërmjet përjasjes me modelin bashkëkohor “të mbikëqyrjes me bazë risku”. Përfshirja e elementëve të këtij modeli do të koordinohet me hartimin e metodologjisë së re të mbikëqyrjes dhe do të mbështetet nga një sistem i plotë elektronik i raportimit dhe analizës. Për realizimin e këtij projekti ambicioz, AMF po bashkëpunon ngushtë me Bankën Botërore dhe Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Konferenca e IOSCO

Autoriteti i Shërbimeve Financiare të Dubait (DUBAI Financial Services Authority) dhe Organizata e IOSCO-së zhvilluan në Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe më 3-6 Dhjetor 2007 konferencën e IOSCO-së e vendeve në zhvillim (IOSCO EMC-Emerging Markets Committee Conference).

Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të enteve rregullatore të letrave me vlerë nga vendet në zhvillim. Në ditën e parë dhe të dytë të konferencës u diskutuan zhvillimet që kanë pasur 5 “Working Groups” që janë krijuar për të trajtuar çështje të ndryshme rreth rregullimit dhe mbikëqyrjes të këtij tregu.

Temat e trajtuara

- o “corporate governance” në vendet në zhvillim;
- o “disclosure & accounting”;
- o shkëmbimi i informacionit ndërmjet enteve rregullatore dhe ecuria e firmosjes së memorandumit multilateral të IOSCO-s (IOSCO MmoU);
- o faktorët që influencojnë likuiditetin e tregjeve financiare;
- o rregullimi i tregjeve sekondare;
- o rregullimi i ndërmjetësve të tregjeve financiare;
- o menaxhimi i investimeve etj.

Përfaqësues të disa vendeve në zhvillim si Malajzia, Tailanda, Nigeria dhanë prezantime në lidhje me eksperiencat përkatëse mbi mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregjeve të letrave me vlerë.

Në ditën e tretë të konferencës, pati prezantime nga Dr. Ahmed Saad, Kryetar i Autoritetit të Tregut të Kapitalit të Egjiptit (Capital Market Authority of Egypt); Z. Peter Bennet, Chief Operating Officer, Pan African Commodities and Derivatives Exchange (PACDEX); Dr. Carlos Barsallo, Kryetar i Komisionit të Letrave me Vlerë të Panama-së.

Gjithashtu, Zj. Ana Carnaval, përfaqësuese e FMN-së dha një prezantim në lidhje me implementimin e parimeve të IOSCO-s në vende të ndryshme të botës dhe ecurinë e implementimit të këtyre parimeve.

Kryetari i komitetit të vendeve në zhvillim (EMC committee), Z. M. Damodaran informoi se takimi tjetër për vendet në zhvillim do të bëhet në Marokesh, Marok.

Parimet e IAIS

Parimi 6: Ndjeshmëria ndaj riskut

Regjimi i mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe aftësisë paguese duhet të jenë të ndjeshëm ndaj riskut

25. Regjimi i Mjaftueshmërisës së Kapitalit dhe aftësisë paguese përmban:

- o Vlerësimin e detyrimeve (duke përfshirë provigjonet teknike);
- o Kërkesat lidhur me aktivet (duke përfshirë kërkesat për vlerësimin e aktiveve);
- o Përcaktimin e formave të përshtatshme për kapitalin;
- o Marzhin e aftësisë paguese të kërkuar.

26. Vlerësimi i aktiveve dhe detyrimeve varet nga baza ligjore lidhur me standartet e kontabilitetit në juridiksionin përkatës.

27. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese duhet të reflektojë risqet të cilat nuk janë marrë në konsideratë në vlerësimin e detyrimeve dhe kërkesave lidhur me aktivet. Kjo përfshin ekspozimet në llogaritë jashtë bilancit.

28. Regjimi lidhur me aftësinë paguese dhe mjaftueshmërinë e kapitalit si një pjesë e vetme duhet të lidhet me risqet me të cilat përballet një shoqëri sigurimi dhe duhet t'i qëndrojë i saktë në çdo moment ndryshimeve të këtyre risqeve në kohë.

29. Autoritetet mbikëqyrëse mund të

konsiderojnë përdorimin e modeleve të brendshme të kapitalit si bazë për kërkesat e kapitalit për sa kohë që ky model është vlerësuar si i përshtatshëm për qëllim nga mbikëqyrësi.

Parimi 7: Nivelet kontrolluese

Një nivel kontrollues është i nevojshëm

30. Autoritetet mbikëqyrëse të sigurimeve duhet të përcaktojnë një nivel apo një seri nivelesh të kontrollit në mënyrë që të sinjalizojë për ndërhyrjen prej autoritetit në biznesin e një shoqërie sigurimi në momentin që niveli aktual i aftësisë paguese bie nën këtë nivel kontrollues. Këto nivele kontrolluese mund të mbështeten prej një akti ligjor specifik apo nëpërmjet një akti ligjor më të përgjithshëm duke i bërë të mundur autoritetit mbikëqyrës lirshmërinë e veprimit.

31. Niveli kontrollues duhet vendosur në mënyrë që të jetë mjaftueshmërisht i lartë për të lejuar ndërhyrjen në mënyrë që ndërhyrja të ketë kohë me nisjen e vështirësive të shoqërive të sigurimit, si dhe mundësi reale për përmirësimin e situatës.

32. Regjimi mbikëqyrës duhet të sigurojë disa mjete për organizimin e daljes nga tregu të shoqërive siguroese dhe për të identifikuar apo përcaktuar qartë statusin e policmbajtësve dhe kreditorëve të tjerë.

Parimi 8: Kapitali minimal

Një nivel minimal i kapitalit duhet specifikuar

33. Baza rregullative duhet të përcaktojë një nivel minimal të kapitalit për t'u zotëruar prej shoqërive.

34. Ky nivel minimal i kapitalit përcakton një minimum sigurie për stabilitetin dhe qëndrueshmërinë financiare të siguruesit.

35. Niveli i kapitalit minimal të kërkuar duhet përlogaritur në mënyrë të tillë që t'i përgjigjet gjithë risqeve që duhen mbuluar. Niveli minimal i kapitalit të kërkuar nuk duhet të përdoret për të kompesuar luhatjet e parashikueshme në zhvillimin e risqeve të caktuara. Gjithashtu as edhe shpenzimet e lidhura me fillimin e aktivitetit nuk mund të mbulohen prej ketij kapitali minimal. Autoritetet mbikëqyrëse të sigurimeve mund t'i imponojnë shoqërive të sigurimit një nivel më të lartë të kapitalit fillestar në momentin e fillimit të aktivitetit në mënyrë që të mbështesë biznesin e tyre gjatë viteve të para të veprimtarisë.

Parimi 9: Përkufizimi i kapitalit

Regjimi lidhur me aftësinë paguese dhe mjaftueshmërinë e kapitalit duhet të përcaktojë një strukturë të përshtatshme të kapitalit

36. Regjimi lidhur me aftësinë paguese dhe mjaftueshmërinë e kapitalit përshkruan strukturën e kapitalit e cila paraqitet e përshtatshme në mënyrë që t'i sigurojnë mbështetje siguruesit në rastet kur ai përballet me ngjarje të papritura ose ekstreme.

37. Në përcaktimin e strukturës së kapitalit të përshtatshëm, autoritet mbikëqyrëse të sigurimeve duhet të konsiderojnë nivelin në të cilin elementët e kapitalit:

- o Përfaqësohen nga investime të përhershme dhe të pa kufizuara të fondeve;
- o Janë në gjëndje të amortizojnë humbjet;
- o Nuk vendosin kosto të pashmangshme ndaj fitimeve të siguruesit;
- o Renditen pas dëmshpërblimeve të policmbajtësve dhe kreditorëve të tjerë në

raste të vështira financiare të siguruesit.

38. Legjislacioni duhet të përmbajë limite mbi nivelin e instrumentave të kapitalit që mund të përfshihet në kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe aftësisë paguese kur këto instrumente nuk përmbahen tërësisht kriteret sipas pragrafit 37.

Parimi 10: Menaxhimi i riskut

Regjimi lidhur me aftësinë paguese dhe mjaftueshmërinë e kapitalit duhet të plotësohet me sistemin e menaxhimit të riskut

39. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese duhet të konsiderohet si mundësia e fundit për të gjitha masat e ndërmarra nga siguruesi për të ruajtur nëse stabiliteti i tij financiar ka dështuar. Siguruesi duhet të ketë sistem të menaxhimit të riskut të përshtatshëm për kompleksitetin, madhësinë dhe gamën e operacioneve të siguruesit.

40. Këto sisteme të menaxhimit të riskut duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të mbulojnë të gjitha risqet ku siguruesi është i ekspozuar. Këto sisteme të menaxhimit të riskut duhet të mbështeten nga sisteme monitorimi gjithëpërfshirëse dhe sisteme të kontrollit të brendshëm.

Parimi 11: Lejimi i risigurimit

Çdo lejim i risigurimit në regjimin e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe aftësisë paguese duhet të marrë në konsideratë efektivitetin e transferimit të riskut dhe të krijojë vend për sigurimin e palës risigurorese

41. Marrëveshjet e risigurimit janë një mjet primar për transferimin e riskut. Çdo kredit në lidhje me risigurimin duhet të marrë në konsideratë transferimin efektiv të riskut të sigurimit sipas kontratave risigurorese.

42. Në rastin e lejimit të risigurimit në

risigurimi duhet vlerësuar duke pasur në konsideratë përshtatshmërinë, seriozitetin, objektivitetin, dhe qëndrueshmërinë.

43. Siguria e risigurimit duhet marrë në konsideratë mirë dhe deri në çfarë mase duhet lejuar risigurimi.

Parimi 12: Dhënia e informacionit

Regjimi lidhur me aftësinë paguese dhe mjaftueshmërinë e kapitalit duhet të mbështetet nga dhënia e informacionit të duhur.

44. Shoqërive të sigurimit u duhet kërkuar të publikojnë informacion të përshtatshëm si nga ana cilësore dhe sasiore lidhur me ekspozimin ndaj risqeve dhe komponentet që përbejnë kapitalin e tyre.

45. Publikimi i ekspozimeve të duhura ndaj risqeve e rrit aftësinë e tregjeve financiare, si dhe në një shkallë më të ulët, aftësinë e konsumatorëve për të gjykuar në lidhje me një sigures të veçantë. Për më tepër, inkurajon siguresit të adoptojnë politika dhe praktika të përshtatshme të menaxhimit të riskut.

Parimi 13: Vlerësimi i aftësisë paguese

Autoritetet mbikëqyrëse të sigurimeve duhet të ndërmarrin vlerësimin e aftësisë paguese

46. Autoritetet mbikëqyrëse të sigurimeve duhet të marrin në konsideratë elementet e mëposhtme në vlerësimin e aftësisë paguese të cilat janë:

- o Përshtatshmërinë, besueshmërinë, objektivitetin, qëndrueshmëria e provigjoneve teknike, vlerësimi i aktiveve, përgjegjësi si dhe raportimit statutor;
- o Përputhjen me nivelin e kërkuar të aftësisë paguese dhe nivelet e kontrollit;

- o Saktësia e vlerësimit të risqeve të brendëshme të siguresit;

- o Sistemet e menaxhimit të risqeve të siguresit.

47. Është përgjegjësia e bordit drejtues dhe e menaxherit të shoqërisë të sigurimeve të manaxhoje këto risqe. Nëse nuk ka sisteme kontolli efikase për monitorimin e ekspozimit ndaj risqeve, siguresi nuk do të jetë në gjendje të adaptohet në kohë me ndryshimet e situatës në treg.

Parimi 14: Përfshirja e dyfishtë

Regjimet e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe aftësisë paguese duhet të reflektojnë çështjen e përfshirjes së dyfishtë si dhe çështje të tjera që lindin nga pjesëmarrja në grup sigurimi.

48. Regjimi i aftësisë paguese dhe e mjaftueshmërisë së kapitalit për siguresit që janë pjesë e një grupi, duhet të marrë parasysh të gjithë grupin kur analizohen kompanitë që janë pjesë e një grupi. Është e nevojshme të merren hapat për shmangjen e përfshirjes së dyfishtë të kapitalit.

49. Duhet marrë në konsideratë financimet brenda grupit.

50. Për një grup sigurimi, trajtimi i transaksionit ndërmjet anëtarëve të të njëjtit grup duhet të konsiderohet si pjesë e regjimit të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe aftësisë paguese.

51. Për më tepër mbikëqyrësit e sigurimeve duhet të marrin në konsideratë riskun e reputacionit dhe të ndikimit.